



**KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË
UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**



Në bazë të nenit 19, paragrafi (1) të Rregullores së Mënyrës dhe të Kushteve të Rregullimit të Tarifave të Transmetimit, të Menaxhimit me Sistemin e Transmetimit dhe të Shpërndarjes së Gazit Natyror („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.201/16, 87/17 dhe 142/18), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar fizikë dhe juridikë se **Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike dhe Industriale**, si bartëse e licencave për kryerjen e veprimtarisë energjetike të shpërndarjes së gazit natyror, të menaxhimit me sistemin e shpërndarjes së gazit natyror të konsumatorëve tariforë të kyçur në sistemin e shpërndarjes së gazit natyror, deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 17.11.2021 parashtroi kërkesë për miratimin e të ardhurave të rregulluara dhe tarifës për periudhën e rregulluar 2022-2026.

Me kërkesën e parashtuar, Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale, kërkon që të ardhurat e rregulluara dhe tarifa mesatare e veprimtarive të shpërndarjes së gazit natyror dhe të menaxhimit me sistemin e shpërndarjes së gazit natyror në vitet e periudhës së rregulluar të jenë:

Përshkrimi		2022	2023	2024	2025	2026
Të ardhurat e planifikuara në nivel vjetor	denarë	15 867 262	16 727 577	16 694 283	17 682 326	18 118 063
Sasitë e planifikuara të gazit natyror të dërguar	nm ³	5 200 000	5 400 000	5 700 000	5 900 000	6 200 000
Tarifa e rregulluar në nivel vjetor	den/nm ³	3,0514	3,0977	2,9288	2,9970	2,9223

Mendimet dhe propozimet në lidhje me të dhënat e publikuara nga kërkesa, personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund t'i dërgojnë më së voni deri në ora 12.00 të datës 30.11.2021 në Komisionin Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes:

- Postës elektronike: erc@erc.org.mk
- Faksit: 02/ 32 33 586
- Adresës: rr. rr. Makedonija pn, pallati L Lazar Pop-Trajkov, kati i 6, 1000 Shkup,

Shkup, 25.11.2021
PA1, nr. 08-233/21

**KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE
TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

